



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 494/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Lazic dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik koalicionit Nisma-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 20.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr. 494/2019 e datës 19.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik koalicionit Nisma-AKR-PD, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me te cilën ka kërkuar që të shpallet i vlefshëm një fletëvotim në Vendvotimin 1915E/01R

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 19.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.494/2019 nga subjekti politik koalicionit Nisma-AKR-PD, në të cilën pretendohet se më 19.11.2019 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave në kutinë e votimit 1915E/01R është shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim ku shihet se janë votuar dy subjekte politike ai me numrin rendor 126 LVV dhe subjekti politik 127 KDTP.

Sipas parashtruesit të ankesës KQZ-ja, ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim në kundërshtim me Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së., dhe kërkon që fletëvotimi nga kjo kuti e votimit të shpallet i pavlefshëm.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LQP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit: 1915E/01R është e shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim nga ana e QNR-së, edhe pse shihet se janë votuar dy subjekte politike ai me numrin rendor 126-LVV dhe subjekti politik me numër rendor 127-KDTP. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e numërimit e ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim.

Subjekti politik Nisma – AKR – PD, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pa vlefshëm sepse të metat apo gabimet të cilat i referohet QNR-ja janë kritere që e bëjnë të pa vlefshëm një fletëvotim.

Paneli, me rastin e vendosjes së ankesës dhe përgjigjes në ankesë ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se fletëvotimi i gjetur në kutinë e votimit 1915E/01R duhet të shpallet i pavlefshëm për shkak të mos përmbushjes së kritereve për të qenë e vlefshme e njëjta.

Në fletëvotimin që është ekzaminuar shihet se në rubrikën me numër 126 subjekti politik LVV, ka të shënuar tik-un ndërsa edhe tek rubrika me numër 127 subjekti politik KDTP, është e shënuar një tik i vogël e cila nuk ka të bëjë me vullnetin e votuesit. Kështu që Paneli ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se i përmbush kriteret e vlefshmërisë, dhe duhet t'i bashkëngjitet rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 494/2019 më datën 20.11.2019

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

**Kryesues i Panelit
Gyltene Sylejmani**

